



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.01.2022, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 07.12.2021.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Europian në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2020 në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)”.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për ngritjen dhe funksionimin e një qendre të përbashkët policore dhe doganore”.
4. Projektligji “Për ratifikimin e konventës 190 “Konventa për dhunën dhe ngacmimin” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës 1986”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Greta Bardeli, Blendi Klosi, Taulant Balla, Tomor Alizoti, Klodiana Spahiu, Lavdim Krashi, Belind Këlliçi, Vangjel Dule, Blerina Gjylameti, Kreshnik Çollaku, Benet Beci

Mungojnë:

Besion Ajazi, Alqi Bllako, Grida Duma, Shpëtim Idrizi, Tritan Shehu, Hatixhe Konomi

Të ftuar:

Megi Fino – Zëvendësministre për Europën dhe Punët e Jashtme

Sonila Muskaj – Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e IPA-s Kombëtare në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Andi Mahila – Zëvendësministër i Punëve të Brendshme

Eduart Merkaj – Drejtor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin në Ministrinë e Punëve të Brendshme

Emirjola Yzeiraj – Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Punëve të Brendshme

Vjosana Neziri – Drejtoreshë Juridike në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave

Ilia Bili – Drejtor i Drejtorisë së Antikontrabandës (DPD)

Olta Manjani – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Luljeta Krasta – Përgjegjëse në Sektorin e Marrëdhënieve të Punës dhe Dialogut Social në Ministrinë Financave dhe Ekonomisë.

Genta Prodani - Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Politikave të Punësimit dhe Migratore

Merita Xhafaj - Drejtore e Përgjithshme në Drejtorinë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e parë të Komisionit për Politikën e Jashtme, datë 20.01.2022.

Në rend të ditës kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 07.12.2021, si dhe diskutimin e tri projektligjeve, të cilat po i citoj me radhë: projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit European në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2020 në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Etjen Xhafaj. Është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë për ngritjen dhe funksionimin e një qendre të përbashkët policore dhe doganore”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Lavdrim Krrashi.

Së fundi, është projektligji “Për ratifikimin e konventës 190 “Konventa për dhunën dhe ngacmimin” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës 1986”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relatore është kolegia Klodiana Spahiu.

Nëse nuk ka vërejtje për procesverbalin e mbledhjes së datës 07.12.2021, e konsideroj të miratuar.

Fillojmë pa humbur kohë me diskutimin e projektligjit të parë.

Për të folur për projektligjin e parë kemi të ftuar zëvendësministren për Europën dhe Punët e Jashtme, zonjën Megi Fino.

Mirë se keni ardhur, zonja Zëvendësministre!

Gjithashtu, është edhe zonja Sonila Muskaj, përgjegjëse sektori në Drejtorinë IPA Kombëtare pranë të njëjtës ministri.

Zonja Fino, dy fjalë për projektligjin.

Fjala për ju.

Megi Fino – Faleminderit!

E nderuara zonja kryetare e komisionit,

Të nderuar anëtarë të Komisionit për Politikën e Jashtme,

Qëllimi i këtij projektligji është të ratifikojë marrëveshjen e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit European në lidhje me programin vjetor të veprimit për Shqipërinë për vitin 2020, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)”. Marrëveshja e financimit është miratuar në parim nga ana e

Këshillit të Ministrave nëpërmjet vendimit nr. 157, datë 17.03.2021, “Për miratimin në parim të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Europian në lidhje me programin vjetor të veprimit për Shqipërinë për vitin 2020, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit, e cila është nënshkruar nga koordinatori kombëtar i fondeve IPA në datën 12 prill të vitit 2021.

Procesi programues për programin vjetor IPA 2020 ka nisur në vitin 2018 me identifikimin e prioriteteve për mbështetje nga zyra mbështetëse e koordinatorit kombëtar të fondeve IPA për të dyja programet IPA 2019 dhe IPA 2020 në bashkëpunim me zyrën e Kryeministrit, me Departamentin për Zhvillim dhe Mirëqeverisje, me delegacionin e BE-së në Tiranë, si dhe me institucionet qendrore shqiptare, të cilat janë edhe përfituesit e veprimeve të këtij programi.

Programi IPA 2020 përbëhet nga shtatë veprime në sektorët: demokracia dhe qeverisja; shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore dhe konkurrueshmëria, inovacioni, bujqësia dhe zhvillimi rural.

Kostoja totale e vlerësuar e këtij programi është 105 milionë e 421 mijë e 991 euro dhe kontributi maksimal i unionit në këtë program është vendosur 103 milionë e 300 mijë euro.

Fondet IPA kombëtare janë të natyrës së grantit dhe kontributi i BE-së vjen falas për zbatimin e veprimeve/projekteve që janë pjesë e këtij programi përkundrejt përmbushjes së disa kushteve dhe përzgjedhjes së prioriteteve të identifikuara në dokumentin strategjik kombëtar 2014-2020.

Kryesisht fondet IPA kombëtare menaxhohen nga vetë Komisioni Europian dhe në disa raste nga strukturat e menaxhimit indirekt të vendit përfitues, pra të Shqipërisë.

Më konkretisht nëpërmjet IPA 2020 mënyra e zbatimit të fondeve do të realizohet nëpërmjet instrumentit të mbështetjes buxhetore sektoriale, prokurimeve, granteve dhe subgranteve. Sjell në vëmendje se është viti i dytë programues që Komisioni Europian do të zbresë në nivelet e bashkive për forcimin e kapaciteteve të tyre dhe për përmirësimin e shërbimeve me ofrim të standardizuar të shërbimeve publike. Grandmarrësi do të menaxhojë mbështetjen për bashkitë në formën e nëngranteve. Këto subgrante janë një komponent i veprimit të BE-së për mirëqeverisjen. Për këtë qëllim institucioni qendror do të mundësojë një shumë indikative prej 194 mijë e 444 euro si bashkëfinancim kombëtar si detyrim i shtetit shqiptar për të përfituar nga këto subgrante. Në rastin konkret është Departamenti për Koordinim dhe Mirëqeverisje, i cili garanton zbatimin e këtyre fondeve përkundrejt aplikimeve për grante për shumën 2,5 milionë euro.

Përmenda pak më parë sektorët, ku do të mbështeten shtatë veprimet. Këto veprime po i citoj vetëm si tituj dhe ndoshta relatori mund t'i zhvillojë më tej. Këto veprime, të cilat janë pjesë e paketës IPA 2020, janë si më poshtë:

Veprimi i parë: BE-ja për mirëqeverisjen;

Veprimi i dytë: mbështetja e BE-së për pjesëmarrjen në programet e saj;

Veprimi i tretë: instrumenti i integritimit në BE;

Veprimi i katërt: BE-ja për shtetin e së drejtës;

Veprimi i pestë: BE-ja për të drejtat e pronësisë;

Veprimi i gjashtë: Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit “Mbështetje për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri – faza II”;

Veprimi i shtatë: BE-ja për rimëkëmbjen ekonomike.

Duke marrë shkas edhe nga disa pyetje që u ngritën dje në Komisionin e Ligjeve, do të doja të shprehja paraprakisht se ne raportojmë çdo 3 muaj dhe, gjithashtu, hartojmë një raport vjetor përmbledhës për çështjet e integritimit Europian dhe IPA-t, të cilat u dërgohen rregullisht parlamentit.

Si projekte konkrete të IPA 2020 janë bashkëlidhur edhe shtatë dokumentet e veprimit ose projektet që do të financohen nga ky program, të cilat janë edhe pjesë e shtojcës 1 të marrëveshjes.

Në përfundim, dëshiroj të theksoj se ratifikimi i kësaj marrëveshjeje financimi dhe përmbushja e procedurave të brendshme ligjore do të konkretizojnë më tej bashkëpunimin ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian në kuadër të procesit të integritimit në BE.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, mbetemi të hapur për pyetjet tuaja.

Mimi Kodheli – Faleminderit, Zëvendësministre!

Fjala për kolegun Etjen Xhafaj.

Etjen Xhafaj – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, Zëvendësministre, për prezantimin tuaj!

Të nderuar kolegë,

Sot jemi këtu për propozimin e projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Europian në lidhje me programin vjetor të veprimit për Shqipërinë për vitin 2020, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit, IPA II.

Gjatë gjithë procesit të integritimit vitet e fundit Shqipëria është mbështetur në mënyrë të vazhdueshme nga instrumente e paraanëtarësimit, nga të cilat ky është, gjithashtu, një i tillë,

duke përmbushur një sërë përafrimesh të kuadrit ligjor për sa i përket atij institucional, duke vlerësuar këtu edhe funksionimin e strukturave të reja, siç është ajo e kryenegociatorit.

Për sa i përket IPA II, kjo është në lidhje me programin vjetor të veprimit për Shqipërinë. Në këtë kuadër, instrumenti i asistencës është në përputhje të plotë me të gjithë strategjinë e politikave të qeverisë shqiptare në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Europian. Pjesë e paketës së dokumenteve, që na janë dhënë, është programi kombëtar i veprimit për Shqipërinë për vitin 2020, mbështetja buxhetore e BE-së për mirëqeverisje dhe shtojcat e saj, kushtet, model-raportet dhe specifikimet minimale të sistemit.

Kontributi maksimal i unionit është vendosur 103 milionë e 300 mijë euro. Kontributi i qeverisë shqiptare, e cila duhet të jetë bashkëpjesëmarrëse në këto programe, është 2 milionë e 121 mijë e 991 euro. Vlen të vlerësohet se e gjithë baza ligjore, pra marrëveshja kuadër nëpërmjet Komisionit Europian dhe qeverisë së Shqipërisë për zbatimin e asistencës financiare të unionit për Shqipërinë, sipas instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit, ka hyrë në fuqi më 16 prill 2015.

Kjo marrëveshje mbështet tre sektorë kryesorë, si: demokracia dhe qeverisja; shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore, si dhe konkurrueshmëria, inovacioni, bujqësia dhe zhvillimi rural. Siç e tha edhe zëvendësministrja ka 7 veprime:

Veprimi i parë është BE-ja për mirëqeverisjen me një total fondesh prej 48 milionë e 100 mijë euro, duke përfshirë këtu mobilizimin e të ardhurave të brendshme, ngritjen e kapaciteteve fiskale të njësisve të qeverisjes vendore; planifikimin, buxhetimin dhe koordinimin; si dhe forcimin e kontrolleve mbi alokimet dhe reduktimin e borxheve të prapambetura.

Veprimi i dytë është mbështetja e BE-së për pjesëmarrjen në programet e saj me një total fondesh prej 1 milion e 500 mijë eurosh, e cila, pak a shumë, është vetëshpjegues si titull.

Veprimi i tretë është instrumenti i integritetit në BE dhe vjen nga sektori demokracia dhe qeverisja. Totali i fondeve brenda IPA II është 8 milionë e 300 mijë euro dhe ka të bëjë me një gamë të gjerë veprimesh që nga kërkimi shkencor deri tek të drejtat e njeriut dhe efektiviteti i zbatimit të reformave strukturore.

Veprimi i katërt është BE-ja për shtetin e së drejtës me një total fondesh prej 5 milionë eurosh. Këtu vlen të theksohet se objektivat specifike të këtij veprimi janë: forcimi i kapaciteteve të Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Veprimi i pestë është BE-ja për të drejtat e pronës me një total fondesh prej 5 milionë e 700 mijë eurosh. Gjithashtu, ka një mbështetje institucionale në kuadër të forcimit të mbrojtjes së të drejtës të pronës në Shqipëri, si dhe kapaciteteve institucionale që garantojnë në praktikë të drejtën e pronësisë.

Veprimi i gjashtë është Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, që është një mbështetje për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri, faza II, me një total fondesh prej 8 milionë e 700 mijë eurosh, që është me një objektiv shumë specifik të përgjithshëm. Pra, harmonizimi i sistemit shqiptar të drejtësisë me *acquis communautaire* të BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Veprimi i shtatë është BE-ja për rimëkëmbjen ekonomike me një fond prej 26 milionë eurosh, kontribut kryesisht i BE-së, si dhe me fokus konkurrueshmërinë, bujqësinë dhe zhvillimin rural dhe inovacionin. Kjo është kryesisht në kuadër të rimëkëmbjes ekonomike pas efekteve të pandemisë COVID-19.

Unë besoj se një sërë programesh, siç është edhe ky instrument specifik që do të zbatohet nga institucionet përfituese shqiptare në përputhje me kuadrin e marrëveshjeve rregullatore dhe atyre ndërkombëtare që ne kemi me BE-në, do të ndihmojnë nga njëra anë zhvillimin e sektorëve të ndryshëm në kuadër të anëtarësimit të procesit të hapjes së negociatave dhe anëtarësimit eventual në Bashkimin Europian dhe, nga ana tjetër, kanë edhe një efekt tejet pozitiv mbi institucionin dhe mbi të gjithë administratën publike në Shqipëri, ndaj do t'i ftoja të gjithë kolegët që ta votonim njëzëri.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Xhafaj, për seriozitetin e relatimit të projektligjit!

Fjala për ju kolegë për pyetje dhe komente.

Fjala për ju zoti Kreshnik Çollaku.

Kreshnik Çollaku – Unë e pashë materialin, si dhe duke dëgjuar pjesë të relatimit absolutisht shpreh mbështetjen e marrëveshjes. Patjetër duhet vlerësuar vazhdimi permanent i angazhimit nga institucionet europiane në këtë rast në mbështetje të Shqipërisë dhe procesit integruar të Shqipërisë. Unë jam pozitiv dhe në mbështetje të saj, ndaj e jap votën time, por, nga ana tjetër, do të doja të komentoja se ky rast, si dhe shumë raste të tjera, janë një provë e qartë se rruga jonë drejt integritit në Bashkimin Europian nuk vonohet dhe pengohet nga skepticizmi apo nga dymendësia e institucioneve europiane. Edhe kjo është një ndër provat që vullneti nga partnerët tanë europianë që Shqipëria të jetë pjesë e asaj shoqërie, e atij sistemi është i qartë. Pengesa e pafalshme disavjeçare, e rënduar sidomos në këta vjet, duhet

kuptuar që vjen nga ne, nga brenda vendit, nga brenda strukturave tona të shoqërisë, por edhe angazhimeve dhe përgjegjësisë të institucioneve. Në fund të fundit, këtu nuk dua të bëj as retorikë politike dhe as partiake, por duhet të kuptojmë se integrimi në ato shoqëri ku dominon ligji, ku dominon e drejta nuk është vetëm çështje ligjesh në letër. Çdo qytetar sot mund t'ia bëj pyetjen vetes se në cilën Europë do të shkojë Shqipëria kur ka skena të tilla, si ato të djeshmet të “5 Maji”, ku tërhiqen gra zvarrë nga policia. Unë nuk dua t'i futem nëse kishte të drejtë ajo që kishte shtëpinë apo policia, por skena të tilla nuk janë skena për Europë. Ka sisteme të qytetëruara, të cilat zgjidhen sipas ligjit, sipas respektimit të të drejtave të njerëzve dhe të dinjitetit të njerëzve. Për cilën Europë flasim ne?! Ne aprovojmë ligje këtu dhe shumë mirë bëjmë që i aprovojmë dhe duhen mbështetur, por nuk është vetëm çështje ligjesh, është çështje e sjelljes sonë shtetërore. Ato skena që pamë dje, por edhe të tjera, tregojnë se jemi shumë larg, pa e kuptuar që integrimi në atë shoqëri të Bashkimit European është një integrim i vetes drejt zgjidhjes së respektit të shtetit, të dinjitetit të njeriut dhe të çdo hapësire, ndaj ne nuk e meritojmë të jemi dhe fajin për këtë nuk na e kanë europianët fare. Fajin nuk na e kanë as albanofobët atje, as politikat brenda BE-së, por fajin na e ka kjo prapambetje, ky tranzicion psikologjik dhe mental që, kush vjen, e ka më të lehtë ta zgjidhë me një plakë me 5 policë sesa ta zgjidhë duke e bazuar në ligj në të drejtë dhe në respekt. Në cilën vend europian një situatë, si ajo e djeshmja, zgjidhet në atë formë?! Ma thoni në cilin vend dhe pastaj të kuptojmë pse kemi ngelur kaq vjet dhe jemi vendi i fundit në Ballkan, i cili nuk bën dot asnjë hap para drejt atij procesi.

Unë këtë doja të thosha më shumë si apel. Patjetër që unë e mbështes projektligjin dhe e votoj, por kjo është një situatë për të reflektuar më shumë sesa për të vënë gishtin këtu apo atje. Po nuk u bë ky ndryshim mentaliteti, mendësie, kulture shoqërore dhe shtetërore të mos krijojmë iluzione, sepse në vend do të mbetemi, të fundit në Ballkan do të jemi për turpin tonë dhe të të gjithëve.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Çollaku!

A ka komente të tjera? Nëse nuk ka komente të tjera apo pyetje mendoj ta hedhim në votim projektligjin.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ju falënderoj për bashkëpunimin, kolegë!

Faleminderit për prezencën, zëvendësministrja Fino dhe zonja Muskaj!

Punë dhe ditë mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.01.2022, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për ngritjen dhe funksionimin e një qendre të përbashkët policore dhe doganore”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Greta Bardeli, Blendi Klosi, Taulant Balla, Tomor Alizoti, Klodiana Spahiu, Lavdim Krashi, Belind Këlliçi, Vangjel Dule, Blerina Gjylameti, Kreshnik Çollaku, Benet Beci

Mungojnë:

Besion Ajazi, Alqi Bllako, Grida Duma, Shpëtim Idrizi, Tritan Shehu, Hatixhe Konomi

Të ftuar:

Andi Mahila – Zëvendësministër i Punëve të Brendshme
Eduart Merkaj – Drejtor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin
Emirjola Yzeiraj – Përfaqësuese e Drejtorisë së Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Punëve të Brendshme
Vjosana Neziri – Drejtoreshë Juridike në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave
Ilia Bili – Drejtor i Drejtorisë së Antikontrabandës (DPD)

Mimi Kodheli – Kalojmë te projektligji i dytë “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë për ngritjen dhe funksionimin e një qendre të përbashkët policore dhe doganore”. Ne jemi komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Krrashi.

Të ftuar për projektligjin e dytë kemi zotin Andi Mahila, zëvendësministër i Brendshëm; zotin e Eduart Merkaj, drejtor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin; zonjën Emirjola Yzeiraj, përgjegjëse sektori në Drejtorinë e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës; zonjën Vjosana Neziri, drejtoreshë Juridike në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, si dhe zotin Ilija Bili, drejtor i Drejtorisë së Antikontrabandës (DPD).

Mirë se keni ardhur, zoti Zëvendësministër!

Fillojmë pa humbur kohë me diskutimin e këtij projektligji.

Zoti Mahila, fjala për ju.

Andi Mahila – Faleminderit!

E nderuar kryetare e komisionit,

Të nderuar anëtarë të komisionit, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë. Këshilli i Ministrave ka paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë për ngritjen dhe funksionimin e një qendre të përbashkët policore dhe doganore”. Ky akt, të cilin po diskutojmë, është iniciuar fillimisht nga institucioni i Ministrisë së Brendshme dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Me Greqinë ndajmë kufirin prej 336,3 kilometra, të ndarë në kufij tokësorë 233 kilometra, 78 kilometra kufij detarë, 7,1 kilometra kufij liqenorë dhe 18,1 kilometra kufij lumorë dhe përrenj. Janë në funksion 7 pika kalimi kufitar, të ndara sipas dinamikës së lëvizjes së shtetasve dhe mjeteve: pika kalimi kufitar, që trajtojnë kalimin e shtetasve, mjeteve dhe mallrave, që këto janë 5 pika, dhe pika të kalimit kufitar, që trajtojnë dhe përpunojnë vetëm shtetas dhe mjete.

Në zbatim të strategjisë së menaxhimit të integruar të kufijve, mbështetur në rekomandimet e Bashkimit Europian për vendet e Ballkanit Perëndimor, struktura e Ministrisë së Brendshme dhe ato të Departamentit për Kufirin dhe Migracionin pranë Policisë së Shtetit janë përqendruar në fusha konkrete të bashkëpunimit ndërkufitar me strukturat homologe të Greqisë, bashkëpunim ky që, bazuar në rezultatet e deritanishme, vlerësohet të jetë shumë i mirë.

Duke ndarë të njëjtin kufi me atë gjatësi që referova më lart, përballja me problematikat në shumicën e rasteve është e ngjashme. Problemet e ngjashme kërkojnë zgjidhje të përbashkëta. E vetmja rrugë për të pasur progres të qëndrueshëm për çështje të përbashkëta, me të cilat përballemi është të punuarit sa më afër me partnerin. Ky është edhe thelbi i qëllimit të kësaj marrëveshjeje, që Këshilli i Ministrave ka sjellë në Kuvendin e Shqipërisë për t'u ratifikuar. Natyrisht, bashkë me materialet që janë depozituar në Kuvend është edhe relacioni shpjegues, i cili ka detajuar përmbajtjen dhe formën e kësaj marrëveshjeje. Në mënyrë koncize, për të mos përsëritur ato që janë paraqitur në relacion, do të doja të eidentojta që në këtë marrëveshje janë përcaktuar rregullat e përbashkëta për funksionimin e qendrës, e cila do të ketë një komision të përbashkët, parashikuar kjo në nenin 9 dhe një rregullore, parashikuar kjo në nenin 4.

Komisioni i përbashkët do të përbëhet nga 4 anëtarë për secilin shtet, 2 dhe 2, sepse duhet të eidentojmë që pjesë e diskutimit për negociimin e kësaj marrëveshjeje kanë qenë edhe strukturat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, përfaqësues të së cilës janë këtu. Pra, ky komision i përbashkët është dakortësuar që të përbëhet nga 4 anëtarë, 2 dhe 2 për secilin shtet, pra 2 përfaqësues nga Ministria e Brendshme dhe Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe 2 përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Ky komision do të miratojë dhe do të përpilojë rregulloren e funksionimit të kësaj qendre. Komisioni do të mbledhet 2 herë në vit dhe do të monitorojë aplikimin e kësaj marrëveshjeje, do të identifikojë masat e nevojshme për implementimin dhe do të propozojë nënshkrimin e protokolleve për implementimin e masave specifike lidhur me aplikimin e marrëveshjes.

Qendra e përbashkët për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e bashkëpunimit do të pozicionohet në territorin e Republikës së Shqipërisë, në ndërtesën aktuale të pikës së kalimit kufitar të Kakavijës. E thënë kështu, duket sikur ka ndonjë gjë të madhe, por është 10 metra matanë kufirit, do me thënë aty ku jemi.

Është për t'u eidentuar që kjo qendër nuk do të ketë personalitet juridik, që do të thotë nuk ka autoritet në vendimmarrje, parashikuar kjo në pikën 1, të nenit 4.

Pikë e veçantë ose çështje e veçantë e parashikuar në këtë marrëveshje, është edhe shkëmbimi i përbashkët i të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve, i cili do të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar për secilin shtet, duke pasur parasysh kushtet e përcaktuara nga autoriteti kompetent ofrues dhe parimeve vijuese, të cilat aplikohen, si për përpunimin e të dhënave automatike, edhe për ato joautomatike. Për këtë

arsye kjo marrëveshje ka një kapitull të veçantë, kapitulli 4, me 2 nenet e tij, neni 12 dhe neni 13, të cilat detajojnë elementet për shkëmbimin e përbashkët të të dhënave personale.

Siç e thashë në relacion, janë të parashikuara ose janë të sqaruara ato që marrëveshja parashikon se cilat janë informacionet që do të shkëmbehen, nuk mendoj se është e nevojshme për t'i përsëritur.

Për sa u takon procedurave, siç e thashë, institucioni që e ka drejtuar këtë proces dhe negociimin ka qenë Ministria e Brendshme në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe janë ndjekur të gjitha procedurat konform ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë fazës së negociimit dhe miratimit në parim projektakti i është dërguar për mendim Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, DSIK-së. Në fazën e marrjes së mendimeve për formën e miratimit të projektligjit, memorandumit, ky akt iu dërgua për mendim Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, siç e thashë, e cila është shprehur parimisht dakord. Marrëveshja është miratuar në parim me vendimin nr.178, datë 4.04.2018 të Këshillit të Ministrave dhe është nënshkruar në datën 18 janar 2021 në Kakavijë, nga zëvendësministri i brendshëm, Julian Hodaj.

Për sa u takon çështjeve të kostove dhe pajisjeve që parashikon kjo marrëveshje, referuar nenit 10 të saj, kostoja financiare e përafërt nga shpenzimet që do të lindin prej veprimtarisë së qendrës, do të jetë për shpenzimet elektrike në një përafërsi 50 euro në muaj, gjithsej rreth 600 euro në vit, shpenzimet e ujit do të jenë afërsisht 15 euro në muaj, gjithsej 180 euro në vit, shpenzimet e mirëmbajtjes do të vlerësohen sipas punimeve të kryera, të cilat do të mbulohen nga të dyja palët. Për shpenzimet e personelit nuk do të ketë efekte financiare shtesë, pasi punonjësit do të jenë pjesë e strukturave aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe konkretisht të Departamentit për Kufirin dhe Migracionin. Kostot financiare, të parashikuara dhe të përlogaritura sa më sipër, do të përballohen nga programi buxhetor, Policia e Shtetit, janë tashmë të përfshira. Shpenzimet që do të lindin nga veprimtaria e qendrës si mirëmbajtja, energjia, uji dhe ngrohja, do të ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet palëve, ndërsa të gjithë pjesën tjetër, godinën dhe të gjitha elementet e tjera të funksionimit të kësaj qendre në aspektin e infrastrukturës, do të mbulohen nga pala greke.

Në përfundim, ne vlerësojmë se funksionimi i kësaj qendre nuk do të sjellë mbivendosje me organet doganore e policore, pasi qëllimi është rritja dhe forcimi i bashkëpunimit të autoriteteve kompetente të palëve, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, duke mirëpërcaktuar detyrat e qendrës, të pavarura nga detyrat e organeve policore.

Jam i hapur për pyetjet tuaja.

Faleminderit për vëmendjen!

Mimi Kodheli – Të falënderoj, zëvendësministër!

Kolegu Krrashi ka fjalën.

Lavdrim Krrashi – Ju falënderoj, zoti zëvendësministër, për përshkrimin shumë të detajuar të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë për ngritjen dhe funksionimin e një qendre të përbashkët policore dhe doganore”.

Pa dashur të hyj në përsëritje, unë kam veçuar disa pika, që mendoj t’i ritheksoj, jo se ju nuk i thatë.

Qendra që propozohet të ngrihet do të përfaqësohet nga të dyja palët, siç e thatë edhe ju, dhe do të funksionojë me një komision të përbashkët nga të dyja shtetet, nga të dy palët. Të mos harrojmë që Greqia është fqinji ynë jugor dhe vend anëtar i Bashkimit Europian, ku ne synojmë të integrohemi, ndërkohë të dy bashkë jemi anëtarë të NATO-s dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Pra, jemi partnerë të barabartë.

Kjo qendër do të kryejë analizën dhe shkëmbimin e informacionit, si dhe do të mbështesë në ekzekutimin e veprimtarive të autoriteteve kombëtare respektive, posaçërisht të autoritetit të policisë dhe të doganave. Shkëmbimi i informacionit do të bëhet mbi bazën e interesave të përbashkëta, asnjëherë të njëanshme, dhe mbi bazën e barazisë dhe të reciprocitetit. Gjëja që dua të theksoj dy herë, është se marrëveshja i ka kushtuar një vëmendje të veçantë ruajtjes dhe mbrojtjes së të dhënave personale, duke parashikuar në marrëveshje, por edhe në rregullore, duke përcaktuar shumë qartë si do të ruhen të dhënat personale të qytetarëve apo të subjekteve, të cilët do të monitorohen nga kjo qendër e përbashkët.

Qendra nuk ka autoritet vendimmarrjeje. Autoriteti i vendimmarrjes vazhdon të ushtrohet nga autoritetet e të dy vendeve, në rastin e vendit tonë nga Policia e Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Krijimi i qendrës nuk krijon mbivendosje, ashtu siç e thatë edhe ju. Unë e shoh edhe si një mundësi për të shkëmbyer praktikat më të mira mes dy vendeve. Patjetër të dyja palët kanë se çfarë të mësojnë prej njëra-tjetrës dhe kanë se çfarë t’i mësojnë njëra-tjetrës. Kjo mendoj unë do të ndikojë në rritjen dhe përmirësimin përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit shumë të mirë, të shkëlqyer, do të thosha, që ekziston ndërmjet autoriteteve të të dyja vendeve deri më tani.

Në këtë frymë, u kërkoj të gjithë kolegëve të komisionit të votojnë pro ratifikimit të kësaj marrëveshjeje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, koleg!

A keni pyetje ose komente?

Po, zoti Dule.

Vangjel Dule – Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti zëvendësministër, do të dëshiroja t'ju bëja një pyetje për pikat e kalimit kufitar.

Nuk e di nëse ju ka rënë rasti të vizitoni pikën e kalimit kufitar të Sopikut ose të Ripesit, ku zyrtarisht ka shërbim nga ana e autoriteteve të Policisë Kufitare dhe Policisë Doganore.

Në pikën kufitare të Sopikut, në një distancë prej 53-55 kilometër nga Gjirokastra, në kushte normale duhen minimalisht 3 orë për akses dhe në periudhën e dimrit ndonjëherë është i pamundur kalimi për shkak të motit.

A ju pengojnë ju këto kushte infrastrukture në ushtrimin e kompetencave të ministrisë suaj në këto pika të kalimit kufitar; a keni kërkuar nga qeveria të merren masa, sepse nuk është kompetencë e ministrisë suaj? Keni kërkuar të ndërhyhet në këtë infrastrukturë, që krahas aspekteve të tjera, të ndihmohet edhe misioni juaj?

E dyta, folët dhe keni parashikuar, e dëgjova me shumë vëmendje, siç tha edhe kolegu referues, çështjen e të dhënave personale. Pas fenomeneve që patëm për rrjedhje masive të të dhënave personale, a mendoni se duhet që në një fushë kaq të ndjeshme si kjo juaja, të merren masa të mëtejshme, që të mos kemi fenomene të ngjashme?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Dule!

Ka pyetje apo komente të tjera?

Zoti zëvendësministër, fjala për ju.

Andi Mahila – Po e filloj me pyetjen e dytë, që për pyetjen e parë t'ia drejtoj fjalën drejtorit të Departamentit të Kufirit dhe Migracionit, i cili është i informuar në detaje për situatën që paraqiti deputeti Dule.

Për sa u takon masave të mëtejshme që thoni, e theksova që marrëveshja parashikon një kapitull të veçantë për çështjet e shkëmbimit dhe, për shkak të shkëmbimit, të mbrojtjes së të dhënave.

Gjatë shqyrtimit të kësaj marrëveshjeje dypalëshe është marrë në vlerësim edhe ekspertiza dhe legjislacioni i shtetit grek. Aty ku legjislacioni ynë apo praktikata tona mund të

kenë pasur boshllëqe, janë plotësuar nga ekspertiza dhe legjislacioni grek, sepse është marrëveshje partneriteti, reciprociteti. Pra, deri këtu ku jemi, mënyra se si është parashikuar shkëmbimi i të dhënave dhe mbrojtja e tyre, është e plotë, është e garantuar nëpërmjet kësaj marrëveshjeje.

A ka nevojë për masa të mëtejshme? Proceset e bashkëpunimit janë dinamike dhe për këtë arsye, në secilën marrëveshje, kur janë midis dy palëve, krijohen komisione apo struktura, të cilat mbajnë në shqyrtim dhe ndërhyjnë menjëherë për të plotësuar apo apdetuar problematikave që mund të dalin, siç është parashikuar në rastin konkret një komision i përbashkët, që një nga detyrat e tij ka pikërisht plotësimin, apdetimin dhe përditësimin e problematikave që mund të dalin.

Çështja e referuar nga ju për situatën e fundit të ndodhur në Shqipëri nuk është pjesë e përgjegjësisë dhe kompetencës sime, e cila, për më tepër është pjesë e hetimit, por do të doja të garantoja që shkëmbimi i informacioneve nga strukturat e Ministrisë së Brendshme dhe konkretisht Policisë së Shtetit është më se i garantuar. Ne shkëmbejmë informacione që janë objekt i punës dhe i përgjegjësisë së Ministrisë së Brendshme me të gjitha strukturat ndërkombëtare: europiane, atlantike dhe të të gjitha llojeve, dhe nga të gjitha këto struktura partnere kemi marrë vlerësime maksimale dhe garantojmë këtë siguri.

Zoti Dule, në diplomaci ka një parim: kur ulesh me një partner për të shkëmbyer të dhëna sensitive, pyetja e parë që bëhet është: a ke kanal të sigurt komunikimi? Kjo është një pyetje etalon i diplomatëve, Kreshniku e di mirë. Nëse ti nuk ke dhe nuk i del për zot që ke kanal të sigurt komunikimi, nuk të jepen të dhëna. Në të tilla raste, strukturat tona janë të kompletuara me sisteme të sigurta komunikimi të çfarëdolloj të dhëne, si për t'u transmetuar brenda Shqipërisë, edhe nga Shqipëria drejt partnerëve. Kjo është për sa i përket pyetjes së dytë.

Për sa i përket pyetjes së parë, do të doja t'ia kaloja fjalën drejtorit të Departamentit për Kufirin dhe Migracionin në Policinë e Shtetit.

Eduart Merkaj – Faleminderit!

Mimi Kodheli – Një sekondë, drejtor!

Eduart Merkaj – Ndjesë!

Mimi Kodheli - Nënkyetar, ju mund të bëni të gjitha pyetjet që mendoni se duhen bërë.

Para se të marrë fjalën drejtori, nënkryetari do të bëjë pyetjet.

Tomor Alizoti – Nuk ka shumë lidhje me temën, por meqë rrallëherë i kemi prezent punonjësit e policisë dhe përfaqësuesit e ministrisë, sipas konceptit tim pikat kufitare vlejné

për të lehtësuar jetën e qytetarëve ndërmjet dy kufijve, a keni ju një program, sepse kufijtë janë fytyra e vendit, fytyra e qytetit dhe shtetit shqiptar? Policia jonë, kjo është shumë e rëndësishme, pavarësisht se pak e cekim, vjen nga një traditë e një sistemi totalitar; njerëzit nuk kanë pasur gjithmonë raport të mirë me policinë. Për shembull, në Gjermani, që shumë persona pyesin pse u ndryshua ngjyra e uniformave, nga e errët në një ngjyrë të hapur, arsyeja ishte sepse njerëzit në kohën e diktaturës kishin pasur përvoja shumë të hidhura me policinë. A ka ndonjë program apo raport trajnimi për njerëzit që presin qytetarët në kufij? Nga përvoja si qytetar, pikat kufitare, sidomos për brezin tonë, që kemi kaluar edhe diktaturën, lënë shumë për të dëshiruar, si mirësjellja e punonjësve dhe komunikimi me ta. Kjo është fytyra për shqiptarët dhe ndërkombëtarët që hyjnë. Meqenëse jemi në raport të Bashkimit Europian, a kanë pikat kufitare një program për edukimin, për komunikimin me njerëzit që hyjnë në Shqipëri? Kjo është e rëndësishme, dhe pse ndoshta anashkalohet. Nuk ka lidhje me temën, por mund të jepni një përgjigje të shkurtër. Policia duhet të marrë një fytyrë qytetare, jo ndëshkuese, sepse është një psikologji e trashëguar nga diktatura, që policia është ndëshkuese. Edhe duke ardhur sot në Shqipëri në një demokraci hibride, policinë e kemi zgjidhjen e çdo problemi, që është e para e një shteti policor.

Mimi Kodheli –Faleminderit, nënkryetar!

Drejtor, fjala për ju!

Një përgjigje për zotin Dule dhe një koment për nënkryetarin, ju lutem!

Eduart Merkaj – Faleminderit!

Për pyetjen e zotit Dule, duke dashur të plotësoja edhe komentimin që bëri zëvendësministri për ruajtjen e të dhënave personale, aktualisht, nga 13 maji i vitit 2013, qershori i vitit 2013 dhe 7 mars të vitit 2018 funksionojnë tri qendra të përbashkëta të bashkëpunimit policor tripalësh, jo dypalësh. Konkretisht, janë Shqipëri-Kosovë-Mal i Zi, qendra e përbashkët e policisë së Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë në Qaf-Thanë dhe Kafasanë dhe qendra e përbashkët e bashkëpunimit policor me Kosovën, PKK-Morinë. Kjo qendër e përbashkët, që tashmë është firmosur dhe ka ardhur te ju për të kaluar fazat e tjera, është *mot a mot* në të njëjtën mënyrë funksionimi, shkëmbimi të dhënash apo shkëmbim informacioni, siç funksionon me tri qendrat e tjera. E reja dhe pozitivja e kësaj qendre është që ne tashmë po formojmë një qendër me një shtet të Bashkimit Europian, kurse tri shtetet e tjera, siç jemi në dijeni, nuk janë pjesë e Bashkimit Europian. Deri më sot, në të tria këto qendra, që funksionojnë shumë mirë, kemi një lehtësi të shtuar në shkëmbimin e informacionit dhe në goditjen e të gjitha krimeve ndërkufitare, të cilat janë konstatuar apo kanë qenë persona të dyshimtë, të cilët kanë pasur informacione nga ana e policisë së të dyja

shteteve, jo vetëm nga ana e Policisë Kufitare, por edhe nga departamentet e tjera që funksionojnë në Policinë e Shtetit, si Policia Kriminale apo e Rendit dhe Sigurisë Publike, reciprocikisht sipas pjesës së shteteve që përfaqësojnë.

Për sa i përket pyetjes suaj të parë dua t'ju them se Policia e Shtetit, ju e thatë shumë mirë, aq më shumë Departamenti për Kufirin dhe Emigracioni ofron një shërbim edhe në këto dy pika, pasi e kanë detyrim ligjor. Ne, nga ana jonë, si Polici Kufitare, jemi munduar të jemi në pjesën më të mirë të mundshme tonën, qoftë nga ana profesionale, administrative ose dhe ligjore, gjatë funksionimit të këtyre pikave

Sa i përket infrastrukturës, duhet t'ju them se Policia e Shtetit dhe Ministria e Brendshme mbajnë kontakte të rregullta me të gjitha ministrinë për ato pjesë që ne i shohim se nuk shkojnë mirë, qoftë në kuadër të infrastrukturës, të rrugës, por qoftë edhe në kuadër të infrastrukturës tjetër, që ka nevojë çdo pikë e kalimit kufitar.

Kështu që, ne vazhdojmë komunikimet dhe kemi pasur kontakte shkresore administrative me të gjitha ministrinë e linjës, që kanë funksion të përmbushin këto detyrime.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Zëvendësministër, a keni komente?

Andi Mahila - Sa i takon pyetjes nëse ka një program për trajnimin, nuk ka një program, por ka një strategji kombëtare për menaxhimin e integruar të kufijve ku pjesë të saj, ku pjesë të saj janë edhe elementet e trajnimit të oficerëve të policisë për mirësjelljen që duhet të kenë me qytetarët. Patjetër, raste të sjelljes jo të mirë ka, por nuk janë shumë. Doja të bëja një vlerësim krahasues. Janë raste të veçuara, për të cilat në të gjitha rastet janë analizuar dhe marrë masat. Kështu që, ajo që doja të garantoja është që trajnimi i të gjitha strukturave të Policisë së Shtetit është i përditshëm, i përhershëm dhe i bazuar në një strategji të mirëpërcaktuar. A ka pasur rezultate kjo strategji? Patjetër që ka pasur rezultate. Cilat janë ato? Policia e Shtetit sot nuk është ajo që ka qenë para 30 vjetëve, madje nuk ka asnjë lidhje me atë polici.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

E kuptova, edhe unë metaforës po i përgjigjem. Pra, nuk bie dakord që perceptimi për Policinë e Shtetit është ai që qenka ndëshkuese. Por, natyrisht, pjesën e ndëshkimit Policia e Shtetit, si organ i zbatimit të ligjit, i ka pjesë funksionale të detyrave të saja. Tani unë nuk dua të futem në politikë, por në pluralizëm opozitë dhe pozitë është rotacion, kështu keni qenë ju, kanë qenë edhe të tjerët.

Mimi Kodheli – Zoti zëvendësministër, ju jeni të prezumuar t'i përgjigjeni pyetjes pa komentuar komentet e deputetëve. Deputeti mund të thotë atë që e mendon dhe siç e mendon,

pa qenë e nevojshme të thoni nëse ju bini dakord me atë që deputeti thotë. Ju bë pyetja, dhatë përgjigjen.

Faleminderit!

Eduart Merkaj - Unë desha vetëm të rikonfirmoj: ju u shprehët në prezantim që qendra do të pozicionohet në territorin e Republikës Greqisë, te dogana.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli - Zoti Petro.

Petro Koçi – Unë e mbështes projektligjin dhe mendoj se është një hap i madh përpara për të luftuar krimin e organizuar, migracionin e paligjshëm, trafiket e paligjshme, evazionin doganor. Nuk është pikë e përbashkët e kalimi i kufirit, as pikë e përbashkët e kalimit doganor, është qendër e përbashkët, që më shumë shkëmben të dhënat ose njëlloj administrimi të përbashkët të dhënash. Nga përvoja ime si ish-ministër i rendit publik, ka qenë gjithmonë jetike çështja e shkëmbimit të informacionit. Pra, mendoj se kjo qendër është një qendër, që do të krijojë avantazh shumë të madh në luftën ndaj krimit. Fakti që ne kemi qendra të tjera të përbashkëta, përveçse pika kalimi të përbashkëta kufiri, tregon se tani kemi një përvojë shumë të mirë. Greqia është një vend anëtar i BE-së dhe mendoj se është një hap i madh përpara që kemi bërë këtë lloj marrëveshjeje me një vend të BE-së.

Të mos harrojmë që Kakavija është një pikë kufiri me intensitet shumë të lartë dhe mendoj se është zgjedhur mirë edhe pika për të krijuar këtë qendër të përbashkët.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Nëse nuk ka komente të tjera, hedhim në votim në parim projektligjin.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.01.2022, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e konventës 190 “Konventa për dhunën dhe ngacmimin, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës 1986”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Greta Bardeli, Blendi Klosi, Taulant Balla, Tomor Alizoti , Klodiana Spahiu, Lavdim Krashi, Belind Këlliçi, Vangjel Dule, Blerina Gjylameti, Kreshnik Çollaku, Benet Beci

Mungojnë:

Besion Ajazi, Alqi Bllako, Grida Duma, Shpëtim Idrizi, Tritan Shehu, Hatixhe Konomi

Të ftuar:

Olta Manjani - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë
Luljeta Krasta - Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Marrëdhënieve të Punës dhe Dialogut Social në Ministrinë Financave dhe Ekonomisë.

Mimi Kodheli - Kalojmë te projektligji i fundit, “Për ratifikimin e konventës 190 “Konventa për dhunën dhe ngacmimin” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës 1986”.

Ne jemi komision për dhënie mendimi, relaton kolegia Spahiu. Të ftuar për të diskutuar këtë projektligj kemi zonjën Olta Manjani, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë, zonjën Krasta përgjegjëse e sektorit të Marrëdhënieve të Punës dhe Dialogut Social.

Faleminderit!

Fjala për ju zëvendësministre.

Olta Manjani – Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka marrë iniciativën për ratifikimin e kësaj konvente.

Ratifikimi i kësaj konvente ka për qëllim pozicionimin e vendit tonë në grupin e vendeve, që kontribuojnë në luftën kundër fenomenit shqetësues dhe kërcënues për dinjitetin, shëndetin dhe sigurinë në punë dhe në garantimin e një mjedisi punë të sigurt.

Në sesionin e 108-të të konferencës vjetore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ILO, në 100-vjetorin e themelimit të kësaj organizate, në datën 21 qershor 2019, është miratuar konventa nr. 190, e cila ka në fokus eliminimin e dhunës dhe të ngacmimeve me bazë gjinore në vendin e punës.

Objektivat që synohen të arrihen me ratifikimin e kësaj konvente janë si vijon: forcimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor ekzistues; krijimi i hapësirave në zbatimin e parimeve të kësaj konvente, duke përmirësuar legjislacionin kombëtar; përafrimin e standardeve ndërkombëtare të punës të ILO-së atë të BE-së dhe vendeve të tjera të zhvilluara në këtë fushë; nxitjen e ndërveprimit të organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe parimeve të kësaj konvente, duke përmirësuar legjislacionin kombëtar, përfarimin me standardet kombëtare të punës; nxitjen e ndërveprimit të organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe strukturave përgjegjëse shtetërore në luftën kundër këtij fenomeni. Gjithashtu, institucioni do të përmbushë siç duhet detyrimet për të mbrojtur viktimën, përfshirë edhe kategoritë më vulnerabël për një mjedis pune të shëndetshëm dhe miqësor; rritjen e ndërgjegjësimit, formimi profesional dhe mbrojtjen efektive të viktimave të prekura nga dhuna dhe ngacmimi në botën e punës, duke ndikuar në sigurinë, shëndetin dhe efektivitetin në punë.

Ratifikimi i kësaj konvente është përputhja me programin e qeverisë shqiptare, e shprehur qartazi në të gjitha instrumentet që gjenden në kuadrin ligjor dhe institucional shqiptar. Ky proces ka avantazhet e veta dhe vendi ynë deri tani ka bërë një përparim të

konsiderueshëm në këtë drejtim. Shumë ligje janë në përputhje me standardet e BE-së të tilla, si Kodi i Punës, ligji për barazinë gjinore, ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë, ligji për arsimin dhe formimin profesional e të tjera.

Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i konventave ndërkombëtare, që janë të rëndësishme në kontekstin e analizës së konventës 190 të ILO-s, janë ratifikuar tashmë dhe kjo e bën më të lehtë përqasjen me këtë konventë. Projektligji është dërguar për mendim në Ministrinë e Drejtësisë dhe në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, e cila na kërkoi që të bënim një studim nëse legjislacioni ynë është në përputhje ose jo me parashikimet e konventës.

Për këto arsye, meqenëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk i kishte kapacitetet e duhura për ta bërë këtë studim, iu drejtua Zyrës Ndërkombëtare të Punës, ILO-s, e cila kontaktoi një eksperte të fushë për një analizë më të detajuar të legjislacionit shqiptar për dhunën dhe ngacmimin në punë, për përputhshmërinë e saj me konventën 190. Nga analiza ka rezultuar se legjislacioni ynë i plotëson kërkesat minimale të konventës, gjë që na mundëson edhe vazhdimin e procedurës, duke programuar përmirësimin e legjislacionit në vijimësi sa herë bëhen ndryshime në legjislacion dhe për të trajnuar struktura që janë në dispozicion. Zbatimi i kësaj konvente nuk kushtëzohet nga dalja menjëherë e ligjeve, sepse nuk janë ligje të reja dhe nuk kërkohen struktura të reja, por nevojiteshin përcaktime procedurale dhe përcaktime të qarta detyrash për të ardhmen. Konventa nr. 190 e ILO-s për eliminimin e dhunës dhe ngacmimin në vendin e punës dhe analiza e legjislacionit shqiptar për dhunën dhe ngacmimin në punë kundrejt përputhshmërisë me këtë konventë u miratuar në parim nga përfaqësuesit e punëdhënësve dhe sindikatat në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Punës. Ratifikimi i kësaj konvente do të sjellë zbatimin e dispozitave ligjore, duke promovuar programe sensibilizuese dhe arsimore në bashkëpunim me partnerët socialë për kauzën e sigurimit të një mjedisi jo të dhunshëm dhe negativ në marrëdhëniet e punës.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Fjala për zonjën Spahiu.

Klodiana Spahiu - Faleminderit!

Unë mendoj se kjo është një ndër konventat më të rëndësishme që krahasohet me konventën e SIDO-s dhe konventën e Këshillit të Europës ose të Stambollit, siç e njohim ndryshe. Them se është një konventë e rëndësishme, sepse është për herë të parë një marrëveshje ndërkombëtare artikulon qartë të drejtën e secilit për një mjedis pune pa dhunë dhe pa ngacmimi. Ne kemi bërë ndryshime ligjore në mënyrë të vazhdueshme. Duke qenë

pjesë e Komisionit të Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, kemi qenë edhe ne komision për dhënie mendimi në çdo ndryshim që është përpjekur ndër vite që të përmirësojë legjislacionin e punës.

Do të doja të theksoja se ne kemi bërë ndryshime në Kodin e Punës në vitin 2015, të cilat në njëfarë mase kanë shërbyer për të frenuar ose për të krijuar një mjedis pune me sa më pak dhunë dhe sa më shumë të drejta për të punësuarit, por kjo konventë ofron mbrojtje jo vetëm për të punësuarit, por tashmë është më e gjerë, sepse ofron mbrojtje, pavarësisht statusit të marrëdhënieve të punës duke përfshirë këtu edhe praktikantët vullnetarët, si dhe punëdhënësit. Zbatohet si në sektorin publik, edhe në sektorin privat dhe është si për ekonominë formale dhe atë informale.

Gjithashtu, dua të theksoj një fakt të rëndësishëm. Ne kemi qenë në bashkëpunim të vazhdueshëm me Këshillin Kombëtar të Punës dhe me të gjitha iniciativat ose kërkesat që ato kanë pasur, nisur edhe nga kërkesat e përfaqësuesve të punëdhënësve, së bashku me sindikatat, por gjithësi vënia në jetë e udhëzimeve ose rekomandimeve që paraqet kjo konventë do të jetë një hap shumë i rëndësishëm. Ne e dimë shumë mirë që ky është një fenomen që ekziston dhe nuk mund të shkojë menjëherë drejt zeros, por përpjekja e vazhdueshme për të bërë përmirësimet e duhura, siç u përmend edhe nga përfaqësuesit në disa nga ligjet më të rëndësishme, ku preken interesat e punonjësve, siç është ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, ligji për shëndetin dhe sigurinë në punë, Kodi i Punës, ligji për barazinë gjinore. Këto përmirësime, nisur edhe nga ndryshimet që do të bëhen duke zbatuar konventën dhe në bashkëpunim me ILO-n, besoj se do të sjellin një rezultat shumë të favorshëm për të arritur qëllimin kryesor, që është e drejta e një vendi pune pa dhunë dhe pa ngacmim.

Duke lexuar të gjithë konventën aty, është në mënyrë të detajuar dhe të qartësuar të paraqitura në 8 kapituj të veçantë, ku janë të përfshirë dhe nenet që janë të rekomanduara nga konventa për t'u zbatuar në ndryshimin e legjislacionit për t'u barazuar me të gjitha vendet e tjera europiane për të drejtat që kanë të punësuarit. Por, siç e thashë në fjalën time, jo vetëm të punësuarit, por edhe praktikantët, edhe ato që janë në kërkim për punë. Doja të theksoja edhe ndryshimet që ne kemi bërë në ligjin për punësimin, ku ne jemi përpjekur në mënyrë të vazhdueshme të jemi në krahun e punëmarrësve, por gjithmonë duke ruajtur një marrëdhënie shumë të mirë midis punëmarrësve dhe punëdhënësve. Gjithashtu, edhe ligji i arsimit profesional na ka ndihmuar shumë për të realizuar një mbrojtje të të drejtave të tyre edhe në nivelin e praktikantit ose atyre që janë në kërkesë për t'u punësuar.

Unë do t'i përgëzoja, në fakt, të gjithë për përpjekjen që kanë bërë. Këshilli Kombëtar i Punës është takuar dy herë dhe ka pasur në mënyrë të vazhdueshme përpjekjen për të bërë të mundur ndryshimet që nuk do të jenë të menjëhershme, por gjithsesi ligjet janë tashmë vetëm për amendime. Unë shpresoj që sa më shpejt të jetë e mundur ne si vend, që e kemi ratifikuar në vitin 2019, një vit pas ratifikimit, duhet të fillojmë ndryshimet në ligj. Shpresoj shumë që këto ndryshime të reflektojnë në një mjedis pune me sa më pak dhunë. Por nuk duhet të harrojmë që kjo përpjekje jona dhe sidomos e të gjithë ne grave në parlamentin shqiptar ka qenë e vazhdueshme për të mbrojtur të drejtat e grave në punë, por jo vetëm gratë. Nëse dum të kemi një mjedis familjar pa punë duhet të kemi edhe një mjedis pune pa dhunë.

Faleminderit!

Ftoj kolegët të votojnë por, sepse rëndësia e kësaj konvente është shumë e madhe, sepse nëse ne realizojmë këto hapa ne shkojmë në Europë me disa kritere shumë të forta për t'u prezantuar edhe ne në mënyrë shumë dinjitoze.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - A keni pyetje?

Zëvendësministre, t'ju them të drejtën, ky është një diskutim sensitiv që dikë më shumë a më pak na prek të gjithëve dhe unë ndaj të njëjtin opinion. Ju falënderoj juve dhe kolegen Spahiu në lidhje me sensibilitetin që ka në lidhje me mjedisin që duhet t'u krijojmë punëmarrësve. Ka gjithmonë një marrëdhënie jo gjithmonë të këndshme midis punëdhënësit dhe punëmarrësit. Ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë kështu. Problemi është që ne duhet të gjithë diferencat delikate midis këtyre dy pozicioneve të mund të afrohen gjithmonë e më tepër. Do të doja që të diskutonim qartë për këtë çështje. Ju përgëzoj që kemi mbërritur në certifikimin e konventës, shpresoj shumë që një ditë të mund të sillni një projekt tuajin që lidhet me *deadline* kohore për ndryshimet që duhen sjellë në legjislacionin shqiptar që të mund të ketë përputhshmëri sa më të madhe midis kuadrit tonë ligjor dhe konventës. Ju dëgjova me vëmendje dhe nëse nuk ju referohem gabim ne kemi një kuadër ligjor minimalist që na ka mundësuar ratifikimin e kësaj marrëveshje, të kësaj konvente që nuk është i mjaftueshëm. Kur flitet për dhunë nocioni është relativ, sepse nuk ka të bëjë vetëm me dhunën psikike por edhe atë psikologjike dhe të gjitha llojet e format e dhunës që një punëmarrës percepton në vendin e tij të punës. Sigurisht kur flasim për ngacmime ndaj të njëjtin opinion me zonjën Spahiu, nuk ka të bëjë me ngacmimet në kuptimin klasik të fjalës por edhe ngacmimet seksuale kur viktimat janë gratë dhe vajzat.

Nga ana tjetër, do të kisha dashur që në vëmendjen tuaj të vinte edhe diskutimi për mjedisin e sigurt të punës, sepse, kur flitet për masat që ne duhet të marrim dhe sa refraktarë

duhet të jemi në zbatimin e këtyre masave për të siguruar jetën, nuk flitet vetëm për njerëzit që punojnë në zyrë, flitet edhe për njerëzit që punojnë në skelë. Pra, jemi më shumë të vëmendshëm ndaj gjobave që u vëmë makinave që ndotin mjedisin në rrugët e qytetit së punonjësve që punojnë më kaskë jo në skela. Ky është një diskutim i gjatë, që mbase nuk duhet bërë sot dhe me ratifikimin e kësaj konvente, por, gjithsesi, ngaqë sensibilizimi është i lartë për fatin tonë të mirë, njerëz të dëmtuar ose me humbje jete në vendin e punës ne kemi relativisht pak, kjo është edhe falë masave që janë marrë ose që zbatohen nga ana e strukturave shtetërore. Por nuk është asnjëherë e mjaftueshme.

Ndaj dhe ju falënderoj dhe shpresoj të shihemi sa më shpejt të jetë e mundur duke sjellë pranë nesh amendimet e kuadrit ligjor, që rregullon ose përmirëson legjislacionin shqiptar kur flitet për mjedisin e punës. A ka komente?

Zoti Koçi.

Petro Koçi – Kam vetëm një ndërhyrje gjuhësore, mendoj se do të ishte më mirë të ishte mbi siç është në variantin anglisht , ose kundër dhunës. Pra ne jemi të detyruar ta kalojmë kështu siç është.

Mimi Kodheli - Kalomë në votimin në parim. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Mbledhjen e sotme e deklaroj të mbyllur.